



KOMUNA E OBILIQ - OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Dalës-izlaza

Nr. V-1532
Br.

Data 20.08.2021
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Komuna Obiliq - Opština Obilić - Municipality Obiliq
Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër

Nr. i protokolit dhe data:

Nr i kërkesës :	05-350-18560
Data:	17.09.2021
Për /Za/To:	KEK Sh.a.
Përmes/Preko/Throug	Zyrës pritëse
Nga/Od/From	Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër
Numri i Lejes ndertimore/	73/2021
Tema/Subjekti/Subjek	-LEJE NDËRTIMORE-

I. Në bazë të Ligjit për Ndertim Ligji nr.04/L-110 neni 18, Ligjit për Procedurën Administrative me Nr.05/L-031, neni 27 pika 1, duke vepruar sipas kërkesës nr.05-350-18560 të dt.12.08.2021 të KEK Sh.a., Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër në procedurë administrative lëshon këtë:

AKTVENDIM

LEJE NDËRTIMORE

Emir i kërkesit:	KEK Sh.a.
Numri i leternjoftimit të pronarit:	
Numri i certifikates se biznesit:	
Qëllimi i kërkesës:	Marrja e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit administrativ
Qëllimi i ndërtimit:	Zyret e DPQ-së, KEK - P+3K -
Nr. i ngastrës kadastrale:	1612-0
Qyteti /Fshati-zona kadastrale:	Zona Kadastrale Obiliq
Lloji i ndërtimit:	Ndërtim i ri

II. Lokacioni për të cilin janë caktuar Kushtet ndërtimore janë dhënë sipas Vendimit për Planin Zhvillimor Urban 2009-2020 me nr.01-166/10 të dt.26.07.2010, Ligjit për Nderim me nr.04/L-110, neni 18, Ligjit për Procedurën Administrative me Nr.05/L-031, neni 27 pika 1 dhe udhëzimit administrative me nr.06/2017 neni 14.

III. Parcela ndërtimore numer 1612-0 ka sipërfaqe prej $S=(15525) \text{ m}^2$, e drejta pronësore –juridike KEK Sh.a., shfrytëzues KEK Sh.a. në bazë të dokumentacionit pronësor - juridik, tokë (e ndërtuar- e pa ndërtuar) me –pa infrastrukturë.

Gabariti dhe etazhiteti i objektit egzistues (/ m^2), nuk është nën mbrojtjen e vlerave kulturore e historike.

A.

LEJE NDËRTIMORE:

I lejohet KEK Sh.a.-investitor, ndërtimi i objektit afarist "P+3K" me dimensione:

Përdhesa	Sbruto = 1 004.84 m²
Kati I	Sbruto = 782.70 m²
Kati II	Sbruto = 782.70 m²
Kati III	Sbruto = 782.70 m²

sipas Kopjes së Planit në ngastrën kadastrale nr. 1612-0, zona kadastrale-Obiliq.

1. Dokumentacionin teknik e ka punuar N.P.N."Data Ing" (810902371) – Prishtinë.
2. Dokumentacioni teknik i vërtetuar nga ky organ në bazë të cilit ipet Aktvendimi është pjesë përbërëse e kësaj Leje ndërtimore.
3. Kushtet Ndërtimore nr:V-572/2021, dt:20.04.2021
4. Informatë për rregullim të dokumentacionit teknik nga KEDS me nr.6491 të datës 16.07.2021.
5. Pëlqimin për dhënien e kushteve teknike nga KUR "Prishtina"SH.A. me nr.251401 të datës.21.06.2021
6. Leja mjedisore e DMM me nr.IX/101 e datës 18.06.2021.
7. Pëlqimin për mbrojtje kundër zjarrit me nr.308/21 të datës 08.07.2021
8. Me rastin e ndërtimit të objektit investuesi është i obliguar :
 - Që të ruaj një ekzemplarë original të dokumentacionit teknik në bazë të të cilit është dhënë Leja e ndërtimit me të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e kryera gjatë ndërtimit.
 - Që të sigurojë shënimin e ngastrës ndërtimore, vijës së regulacionit, nivelizimit dhe vijës ndërtimore.
 - Që këtij organi t'i paraqesë fillimin e punëve më së paku në afat prej 8 (tetë) ditësh para fillimit të objektit.
9. Kjo Leje nuk do të vlejë në qoftë se me punët ndërtimore nuk fillohet në afatin prej 1 (një) vit nga dita e lëshuarjes së Lejes së ndërtimit.



ARSYETIM

KEK Sh.a.për objektin afarist,ku poashtu i njëjti –është investitor i këtij objekti afarist me dimensione:

Përdhesa	Sbruto = 1 004.84 m ²
Kati I	Sbruto = 782.70 m ²
Kati II	Sbruto = 782.70 m ²
Kati III	Sbruto = 782.70 m ²

ka paraqitur kërkesën për ndertim me numer të protokollit 05-350-18560 të dt.12.08.2021 për dhënen e Lejes ndërtimore për ndërtimin e objektit afarist të përshkruar në dispozitiv të kësaj Leje ndërtimore.

Së bashku me kërkesën për dhënen e Lejes ndërtimore, investuesi ka paraqitur :
Projektin kryesorë në së paku 3 (tri) kopje që është kontrolluar nga ana e

Drejtëroratit për Planifikim Urban ,Kadaster dhe Pronë të Komunës së Obiliqit
se ky projekt është bërë në harmoni me kushtet urbanistike-teknike të dhëna nga ky
Drejtërorat .

- Proven mbi të drejtën e pronësisë të ngastrave kadastrale nr.1612-0,e evidentuar me nr. të lëndës 05-1470-2021, KK Obiliq të lëshuar nga Drejtërorati ,
- Kopjen e letërnjoftimit
- Kompenzimi i caktuar me këtë Aktvendim dhe lartësia e tij është bërë sipas tarifave të Ligjit të ndërtimit me Nr.04/L-110 të datës 31 maj 2012 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2018 i dates 29.05.2018.
- Pasi që investuesi së bashku me kërkesën për dhënen e lejes ndërtimore ka paraqitur tërë dokumentacionin e paraparë me Ligjit nr.4/L-110, për të cilin është vendosur si në dispozitiv të kësaj Leje të ndërtimore



KËSHILLA JURIDIKE : Kundër kësaj Leje ndërtimore mundë të paraqitet ankesë Kryetarit të KK Obiliq në afatin prej 8 (tetë) ditësh nga dita e lëshuarjes së kësaj Leje ndërtimore. Ankesa dërgohet përmes këtij organi.

I dorëzohet_:

- Palës
- këtij Drejtorati
- Drejtorisë të inspektorëve
- dhe në arkiv.

Obiliq, 17.09.2021


Punoi
/ Merita Simnica /


Drejtori
/ Arben Berisha /



REPUBLICA E KOSOVES
KOMUNA E OBILIQIT
OBILIC - OBILIC
REPUBLIKA KOSOVA